



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 653 prot.

Tiranë, më 25.06.2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës “Dirigjent” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet në degën e dirigjimit brenda ose jashtë vendit
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se 2 (dy) vjet në fushën e artit skenik si dirigjent
3. Të ketë një biografi që demonstroi një karrierë me njohje të qartë ndërkombëtare
4. Të ketë aftësi të mira koordinimi dhe organizimi të orkestrës
5. Të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit
6. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Programi:

Testet e provimit

- **Vlerësimi i kualifikimeve artistike dhe kulturore**
- **Analiza muzikore dhe drejtuese e një vepre të shek. XIX ose XX, të zgjedhur nga komisioni brenda një kohe maksimale prej 12 (dymbëdhjetë) orësh.**
- **Koncertimin dhe dirigjimin, me një provë prej gjysmë ore, të kohës së parë të një simfonie të shek. XIX ose të XX, të zgjedhur nga komisioni nga simfonitë e:**

1. Schumann (Simfonia 1, 2, 3, 4)
2. Brahms (Simfonia 1, 2, 3, 4)
3. Beethoven (Simfonia 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7)
4. Tchaikovski (Simfonia 3, 4, 5, 6)
5. Rachmaninov (Simfonia nr. 2, Isle of the Dead)
6. Shostakovich (Simfonia nr. 5)
7. Strauss (Der bürger als edelmann; Tod und Verklärung)
8. Mahler (Simfonia nr. 1)

- **Koncertimin dhe dirizhimin, me një provë prej gjysmë ore, të një skene opere, të zgjedhur nga Komisioni ndër sa vijon:**

1. Puccini: La Boheme, Tosca, Turandot, Madama Butterfly
2. Verdi: Macbeth, Trovatore, Rigoletto, Aida, Falstaff,
3. Donizetti: Lucia di Lammermoor
4. Mozart: Le Nozze di Figaro, Don Giovanni

• Testet e kulturës:

1. Lexim i improvizuar, duke e reduktuar në piano, të një pjese operistike dhe shpjegim me këngëtarë të vënë në dispozicion nga Teatri.
2. Pyetje mbi instrumentacionin, orkestracionin dhe njohjen e formave;
3. Diskutim mbi testet me shkrim.

Ditët e provimeve:

E hënë 22 korrik 2024– test analize - 08:00 - 20:00 – STUDIO KU KA PIANO

Provat praktike:

E martë, 23 korrik 2024– provë praktike (simfoni + opera) 13:30 – 15:30 (një orë secila) SALLA E ORKESTRËS (2 kandidatë)

E mërkurë, 24 korrik 2024- provë praktike (simfoni + opera) 13:30 – 15:30 (një orë secila) SALLA E ORKESTRËS (2 kandidatë)

E enjte, 25 korrik 2024- provë praktike (simfoni + opera) 13:30 – 15:30 (një orë secila) SALLA E ORKESTRËS (2 kandidatë)

E premte 26 korrik 2024- Test kulture dhe shoqërim me piano. Vlerësim i titujve artistikë 10:00 HOLLI I KONCERTEVE

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave e noterizuara
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit
6. Libreza e punës e noterizuar
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumenteve sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të depozitohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 15.7.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Dirigjent” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

